

Data 20/07/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Materiale per mirembajtjen e ndricimit publik 2026 Bashkia Dropull”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):31500000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.232.900 (Një milion e dyqine e tridhjetë e dy mijë e nëntë qind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Dropull** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2023, 2024, 2025) lëshuar nga autoriteti përkatës, **ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se **30% të vlerës së përlogaritur të kontratës**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar*; Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2023, 2024 dhe 2025 **ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur **“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare”**, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20 % fondit limit, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës:**

- Kur furnizimet janë realizuar me entet publike duhet të paraqitet kontrata e ngjashme me entin që ka realizuar këtë lloj furnizime shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses nga autoriteti kontraktor.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara e firmosur dhe vulosur nga palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) : “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, germa a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.2 Operatorët ekonomik të interesuar për këtë procedurë prokurimi duhet të sjellin në magazinën e bashkise Dropull nga një mostër për çdo artikull të kërkuar për të parë nëse artikujt janë sipas specifikimeve të kërkuara, përpara datës së hapjes së ofertave.

Argumentimi: Ky kusht është bazuar në udhëzimin Nr. 03, datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga Operatorët ekonomikë dhe në Vendimin Nr. 285, datë 19.5.2021, Neni 40, pika 6/a) ku thuhet: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike e mëposhtme përshkruajnë kërkesat e materialeve me të cilat do të pajiset Bashkia Dropull për mirëmbajtjen e ndriçimit publik rrugor.

Materialet e furnizimit duhet të jenë të reja, të pa përdorura dhe të vijnë nga një prodhues i njohur. Duhet të përmbushin standartet kombëtare dhe ato evropiane (CE,DIN, IEC,VDE,CEN,CE,EMC,ROHSetj.).

Të gjitha produktet e ofruara duhet të vijnë nga impiante industriale që aplikojnë procedura prodhimi të certifikuara sipas ISO-ve nga një organ i akredituar certifikimi. Të gjitha materialet e paraqitura duhet të jenë me cilësi të shkëlqyeshëm, pa defekte, sipas specifikimeve që përcaktohen më poshtë.

Materialet që do të paraqiten duhet të kenë kaluar kontrollet laboratorike, testet, dhe matjet me qëllim të certifikohet cilësia, karakteristikat e veçanta dhe vetitë e tyre.

Të gjitha materialet e paraqitura do të jenë të paketuara siç duhet dhe do të mbartin etiketën që tregon emrin tregtar të tyre, prodhuesin, kohën e prodhimit, jetën e shërbimit të tyre dhe të përcaktohen standartet si dhe të jenë të garantuara.

Duhet të jenë moderne, të reja, me cilësi të shkëlqyeshëm dhe të plotësojnë specifikimet e mëposhtme dhe standartet e aprovuara dhe duhet të shoqerohen me dokumentat e parashikuara të marketingut nga të cilat do të rezultoj lloji dhe cilësia e tyre.

Çdo devijim nga specifikimet teknike i ndonjë nga produktet të ofruar nga fituesi i tenderit, do rezultoj në refuzimin e tyre nga ana e Bashkisë Dropull.

Fituesi i tenderit është përgjegjës për përshtatshmërinë e të gjitha materialeve sipas kushteve përkatëse të specifikuara. **Cilësia e materialëve do kontrollohet nga komisioni përkatës i Bashkisë Dropull i cili mund të ndalojë furnizimin në qoftë se nuk përmbushen kriteret e specifikimeve.**

- **SPECIFIKIME TEKNIKE**

Në tabelën e mëposhtme tregohen specifikimet teknike të materialëve sipas preventivit, me të cilat do të pajiset Bashkia Dropull për mirëmbajtjen e ndriçimit publik rrugor.

Nr. Lloji i Materialit – specifikime teknike

1 Llamba LED 15 Watt

Prodhimi nga Komuniteti Evropian CE. Kërkesat e sigurisë CE. **Vlerësuar me Watt: 15 W.** Tensioni me vlera 220 ÷ 230 VAC. Frekuenca 50 Hz. Dimmable JO. Të jenë të garantuara. **Temperatura e ngjyrave (CCT) 6500 K (light temperature).** Lloji i ndriçimit : i bardhë i ftohtë. Të kenë certifikatën e prodhimit. **Klasa e energjisë ≥ A+. E27.**

2 Nyje lidhëse të izoluara për linjën kryesore (Konjektore abonenti)

Seksionii përcjellësit: 16-95 mm (min-max), Seksionii degëzimit: 1,5-10 mm (min-max)

3 Tirantues ankëror për kabëll ABC, 2x16mm

Përcjellësi i ankoruar: 4x16-95 mm². Ngarkesa: 5 kN. Trupi metalik i tirantuesit: Çeliku i galvanizuar. Shtrëngimi i përcjellësve të linjës realizohet për mes një pakete polimeri.

4 Portollamba plastike E27 me filete metalike

Materiali i trupit të portollambës: Plastike. Kontakte: bakere (Cu). Për ambient të jashtme. E27. Nga pjesa e sipërme të këtyre filetimeve metalike për vidhosjen e saj.

5 Kabëll ABC 2x16 mm² AL/XLPE

Materiali i përcjellësit: Alumin (Al). Seksioni nominal: 2x16 mm². Numri i përcjellësve: 2 (dy). Materiali i izolimit: XLPE, Tensioni i funksionimit: 0,6/ 1 KV. Ngyra e veshjes izoluese: E zezë dhe e kuqe.

6 Leshues Magnetik 5,5 kW, 12AC3 (Kontaktor)

Të jetë i tipit modular për montim në shinë. Releja e kontaktorit të jetë me buton komandimi me dorë. Ushqimi i bobinës 230 V AC. Të kenë çertifikatën e prodhimit nga CE. E garantuar: Po. Tipi: Telemekanik. Fuqia në 380 V: 5,5kW. Hapje/mbyllje (ON/OFF): 1.000.000. Kontakte ndihmëse: 1NO.

7 Kabëll elektrik fleksibëll 3 x 2,5 mm²

Seksioni nominal: 3x2,5mm². Tipi I përcjellësit: poliklon (shumë fije). Materiali I përcjellësit : Bakër (CU). Materiali I izolimit : PVC.

8 Tay rap (kapëse) 25 cm x 3.6 mm (pako përmban 100 copë)

Gjatësia 25 cm. Gjerësia 3.6 mm, Ngjyra: e bardhe ose e zeze. Pakoja përmban 100 cope.

9 Sensor Fotocelul (Muzgu) 220 V, 25 A

Prodhimi nga Komuniteti Evropian CE. Kërkesat e sigurisë CE. Tensioni i funksionimit: 110 ÷ 230 V AC. Frekuenca 50 Hz. **Ngarkesa maksimale Omike: 5500 W. Regullimi I ndriçimit: 1-100 Lux.** Trupi plastik i bardhë ose i zi. Mbulesa e bardhë. **Vonesa: max 6 sec ndezja dhe 25 sec çaktivizimi.** Për ambient të jashtëm. Mbrojtja IP 54. Të kenë certifikatën e prodhimit. Të jenë të garantuara.

10 Prozhektor LED 200 W, IP65, 6500 K, IP 65, Klasa e nergjise ≥ A

Fuqia: 200 watt. I papershkueshem nga uji IP65. Temperatura e ngrave 6500 Kelvin (Ngjyre natyrale). Tensioni i funksionimit 220-240 Volt. Klasa e energjise ≥ A

11 Automat 10 A

Klasi C. Tensioni 230 V. Numri I moduleve 1. Rryma 10 A.

12 Panel (kuti) elektrik plastik i papershkueshëm nga uji, IP65 me kapak plastik me bravë.

Lloji I materialit :Plastik. Me kapak (derë) plastike me bravë. Hapet dhe mbyllet me çelës: Po. Karakteristikat e çelësit: Në formë trekëndore ose e rrumbullakët. Përmasat: Gj.250mm x L.330mm x Th. 140 mm. Për ambient të jashtme: IP 65 dhe IP 66. Përmban krah metalik të galvanizuar në brëndësi për mbështetjen e Automateve, Releve etj. Qendrueshmëri në temperatura deri në 70° C. Ngjyrë: Gri. E çertifikuar CE: Po.

13

Ndriçues elektrik tip braçet për ndriçimin rrugor, (përmbahet portollamba plastike me filete metalike + kabëll 2,5 m. me seksion 2x1,5 mm²)

Kapaku i ndricuesit: i rrumbullaket. Krahu mbështetës: ≥100 cm me kend për mbështetje. Pjastra lidhëse:
Dy cope me gjatësi ≥20 cm secila, Portollambë: PO, Plastike. Kabëll lidhëse perlidhjen me kryesore:
linjen
Po. Seksioni nominal I kabllit : ≥2x1,5mm². Gjatësia e kabllit: 2.5 metra.

Nga njësia e prokurimit.

1-Ervin Llahana

2-Sotir Eksarho

3-Maria Jovani